



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:118273

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876191

Ac.nr.8825/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L.H., B.B., M.M., F.H. dhe F.M., të gjithë nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.G. dhe K.F., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.662/2021, të datës 08.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, C.nr.662/2021, i datës 08.11.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.662/2021, të datës 08.11.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve L.H., B.B., M.M., F.H. dhe F.M. të gjitha nga Vushtrria, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditëses L.H. për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 704.00 euro, paditësit B.B. për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494,00 euro, paditëses M.M. për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 250.00 euro, paditëses F.H. për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494.00 euro dhe paditëses F.M. për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 11.06.2021 e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditësve t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë, për padi shumën prej 312.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo

shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbartimit me detyrim”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin C.nr.662/2021, të datës 08.11.2022 ta anulojë dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore konform dispozitave ligjore ose ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën t’ia kthej në rigjykim organit të shkallës së parë.

Paditësit kanë paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, përmes të cilës i kanë propozuar Gjykatës së Apelit që ta refuzojë si të pa bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimi C.nr.662/2021, i datës 08.11.2022 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, kundër të paditurës kanë parashtruar padi me datën 11.06.2021, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 21.10.2022, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditëseve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, kamatën ligjore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka parashtruar së padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, andaj ka propozuar që e njëjta të hedhet poshtë si e palejuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore, andaj ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.103/2021, të datës 18.10.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vërtetimet e lëshuara nga SHF “Ali Kelmendi” në Vushtrri, është vërtetuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, si dhe që të njëjtit secili veç e veç gjatë periudhës 15.07.2019 deri me 15.03.2021 kanë realizuar numër të caktuar të ditëve të pranisë në punë (më decidivisht si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar). Gjykata e shkallës së parë thekson se ka vepruar konform nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit për një ditë të pranisë në punë njihet shuma 2.00 €, ashtu që paditësve, secilit veç e veç, për numrin e ditëve të pranisë në punë gjatë periudhës së lartcekur x 2.00 € iu ka njohur kompensimin e shujtave ditore në shumat e caktuara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Ndërkaq, pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin, gjykata e arsyeve konform nenit 87 të Ligjit të Punës, duke theksuar periudha e kërkesës, përfshinë periudhën gjatë të cilës Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi, si dhe faktin padia është

paraqitur para gjykatës brenda afatit prej tri vitesh. Tutje, gjykata ka arsyetuar se konform nenit 398 të LPK-së janë plotësuar kushtet për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk ka qenë kontestuese gjendja faktike dhe nuk kanë ekzistuar pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor. Vendimin për kamatën ligjore gjykata e ka arsyetuar konform nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën me numër 265/2020, i datës 01.12.2020, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e arsyetoi konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) dhe o) të LPK-së, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin dhe së gjykata ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadiës. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për marrjen e aktgjykimit pa caktuar fare seancë gjyqësore siç parashihet me nenin 398 të LPK-së, pasi përmes përgjigjes në padi të paditurës është konstatuar se e njëjta nuk e ka kontestuar gjendjen faktike, si dhe është konstatuar së në këtë rast nuk kanë ekzistuar pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, dhe gjykatë e shkallës së parë ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadiës.

Nuk qëndron as pretendimi i të paditurës se gjykata e shkallës së parë duke e vlerësuar kërkesëpadinë e paditësve si të afatshme, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika e) i LPK-së, kjo pasi që kjo dispozitë i referohet vetëm rasteve kur me ligj të veçantë është paraparë afati për ngritjen e padisë në gjykatë. Në rastin konkret paditësit kanë kërkuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe kjo kërkesë konsiderohet si kërkesë nga marrëdhënia e punës në para e cila rregullohet me neni 87 të Ligjit të Punës sipas të cilit: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Duke qenë së paditësit padinë e kanë paraqitur në gjykatë me datë 11.06.2021, ndërsa kompensimin e ushqimit e kërkojnë për periudhën nga data 15.07.2019, deri me datë 15.03.2021, rezulton së në këtë rast nuk kanë kaluar 3 vite në mënyrë që të konsiderohet së kërkesa e paditësve është parashkruar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk është kontestuese se paditësit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Filllore “Ali Kelmendi” në Vushtri, dhe se kjo e fundit nuk iu ka ofruar paditësve ushqim në

punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se gjatë periudhës 15.07.2019 deri 15.03.2021 paditësja L.H. ka realizuar 352 ditë pranie në punë, paditësi B.B. ka realizuar 247 ditë pranie në punë, paditësja M.M. ka realizuar 125 ditë në punë, paditësja F.H. ka realizuar 247 ditë pranie në punë, si dhe paditësja F.M. ka realizuar 247 ditë pranie në punë. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka përlllogaritur kompensimin në shumën 2.00 € për çdo ditë pranie në punë, duke ua njohur paditësve shumat e kompensimit të përcaktuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, për të gjitha arsyet e lartcekura, nuk qëndron as pretendimi i palës së paditur se si pasojë e shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale duke aplikuar nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 7 ka përcaktuar së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditësit kanë realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga Shkolla Fillore “Ali Kelmendi” në Vushtrri, ndërsa e paditura nuk u ka ofruar paditësve ushqimin gjatë punës përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë secilit paditës veç e veç si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, numër 265/2020, i datës 01.12.2020, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS–PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:118273
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876191

Ac.nr.8825/2022, më datë 28.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci